



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 89 prot.

Tiranë, më 06.01.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Qendrës "Res Publica"

Adresa: Qendra "Res Publica"

A: Bul. "Gjergj Fishta", Nd. 24, H. 3, Ap. 7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Në vijim të email-it tuaj dërguar në datë 23 dhjetor 2025, ju lutem gjeni bashkangjitur përgjigjen e Departamentit të Burimeve Njerëzore të Bankës së Shqipërisë.

Me respekt,

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E

INFORMIMIT

FABIOLA ÇELA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 89 prot.

Tiranë, më 06.01.2026

Për: Zj.Fabjola Çela,

Koordinatorë për të Drejtën e Informimit në Bankën e Shqipërisë

Lënda: Kthim përgjigje në lidhje me kërkesën e Qendrës "Res Publica"

E nderuar zj.Çela,

Në vijim të kërkesës tuaj përcjellë përmes postës elektronike të datës 29.12.2025, ju citojmë më poshtë draft përgjigjen për Qendrën "Res Publica":

"I nderuar z.Matlja,

Në vijim të kërkesës suaj nr.prot.191/25, shprehim vlerësimet tona për angazhimin e shoqërisë civile, përfshirë Qendrën "Res Publica" që ju përfaqësoni, në nxitjen e transparencës institucionale.

Sjellim në vëmendje se informacioni i referuar përfshin të dhëna të detajuara voluminoze dhe përpilimi i këtij informacioni paraqet një vëllim të konsiderueshëm pune që kërkon verifikimin dhe sistemin e të dhënave nga njësi të ndryshme të Bankës. Në çdo rast, dëshirojmë t'ju informojmë se ky informacion do të përfshihet në Raportin Vjetor të vitit 2025 të Bankës së Shqipërisë, i cili është në fazën e përgatitjes dhe do të publikohet në faqen zyrtare të institucionit, sipas një tradite tashmë të konsoliduar.

Ju falënderojmë për mirëkuptimin,"

Faleminderit për bashkëpunimin,

DREJTOR

